



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE

Tiranë me 02.03 .2020

**Njoftim mbi përfundimin e procedurës “Lëvizje paralele”  
dhe zhvillimin e procedurës: “Ngritje në detyrë”, për pozicionin  
“Përgjegjës/e, në Sektorin e Ruajtjes së Rendit”.**

Në zbatim të nenit 57, të Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II-të, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentave personale (28.02.2020), të kandidatëve për konkurrim, me procedurën e lëvizjes paralele, asnjë kandidat nuk ka paraqitur dokumentat për konkurrim, për vëndin e lirë të punës “Përgjegjës/e, në Sektorin e Ruajtjes së Rendit”.

Njësia përgjegjëse pranë Gjykatës së Lartë (Sektori i Personelit dhe Shërbimeve) njofton se për vëndin vakant “Përgjegjës/e, në Sektorin e Ruajtjes së Rendit”, do të vazhdohet me procedurën: “Ngritje në detyrë”.

Kandidatët do të paraqesin dokumentat me procedurën e “Ngritjes në detyrë”, deri me datën **04.03.2020** dhe do të marrin informacion në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, duke filluar nga data 13.03.2020.

**NJËSIA PËRGJEGJËSE**

**SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE**

